



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA /  
REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA D.JAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



**Kuvendi i Komunës - Gjakovë**  
01 Nr. \_\_\_\_\_ /2019  
Dt. 04.03.2019

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12, Pika (d), nenit 40 pika (J) të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe nenit 18 të Ligjit nr.04/L-010 Për Bashkëpunim ndër komunal në mbledhjen e mbajtur me dt. 04.03.2019, pas diskutimeve lidhur me pikën e 6-të të rendit të ditës: Themelimi i Nismës për Binjakëzim me Bashkinë e Sarandës të Republikës së Shqipërisë, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Miratohet NISMA për Bashkëpunimin Komunal Ndërkombëtar në mes të Komunës së Gjakovës dhe Bashkisë së Sarandës Republika e Shqipërisë.
2. Bashkëpunimin Komunal Ndërkombëtar në mes të Komunës së Gjakovës dhe Bashkisë së Sarandës-Republika e Shqipërisë, do të bëhet në fushën e Administratës Publike, Ekonomisë, Kulturës, Arsimit, dhe Turizmit.
3. Autorizohet Kryetari i Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini që ti filloj Konsultimet dhe përgatitjen e Propozim Marrëveshjes për bashkëpunim Ndër Komunal .
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

**5. Vendimi iu dërgohet:**

- Kryetarit të Komunës së Gjakovës - z. Ardian Gjini .
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
- Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës
- Arkivit

